

Gjuha e mediave dhe shkarjet kuptimore

Sami ISLAMI

13 qershor 2009

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori ka vënë në spikamë disa raste të përdorimit jo të drejtë të ndërtimeve gjuhësore nga mjetet e informimit publik, të cilat i këndvështron nga aspekti kuptimor- semantik.

Mediat tona, përveç detyrës së tyre parësore, për të dhënë emisione të ndryshme informative kulturore, shkencore, teknike; nëpërmes të artikujve, komenteve a reportazheve të ndryshme që jepen orë e çast, ato luajnë edhe një rol tjetër tepër të rëndësishëm. Ato drejtpërdrejt mund të ndikojnë për pasurimin e gjuhës, në pasurimin e saj me fjalë të reja, me kultivimin e normës së gjuhës letrare. Fatkeqësisht ato mund të bëjnë edhe efekt negativ për sa i takon pastërtisë së gjuhës.

Pse ndodh kjo ?

Kjo ndodh, mendojmë, nga shkakut se dinamika e punës së gazetarëve tanë dhe zhvillimi tepër dinamik i ngjarjeve "nuk lë kohë" për të menduar më shumë për gjuhën. Kemi përshtypjen se gazetarët, në rend të parë, por edhe të tjerët që merren me shkrime duke punuar nën këso trysnishi të mëdha, dhe nën ndikimin e gjuhëve dhe kulturave më të mëdha botërore bëjnë gabime, në njërin anë duke mos i kuptuar drejt fjalët e gjuhës shqipe (shpesh herë duke i ngatërruar ato), në anën tjetër duke u ndikuar edhe nga gjuhët e huaja që gjuha letrare shqipe nuk i duron.

Këtu më poshtë do t'i përmitojmë disa fjalë, të cilat gabimisht po dalin si në mediat elektronike (radio, televizion), po ashtu edhe në ato të shkruara (gazeta, revista) etj. Le ta marrim p. sh. fjalën **vras**. Po para se të shohim përdorimin gabim të kësaj fjale (pra të fjalës **vras**, **vrava**, **vrarë**), të ndalemi pak tek kuptimi i saj. Ja disa kuptime: 1. *e bëj një njeri të vdesë, apo një kafshë të ngordhë, duke e qëlluar me armë (zakonisht me armë zjarri); Vrau një armik, Vrau një ujk etj.*; 2. *godit një pjesë të trupit tim ose një tjetër me diçka duke shkaktuar dhembje a plagë: Vrau syrin, këmbën*; 3. *Më vret këpuca (p. sh. kur ajo është e ngushtë etj.)*; 4. *Më vret dielli (në kuptimin më dhëmbin sytë nga dielli etj) etj. Ka edhe kuptime figurative; si, sikur e prek dikë në sedër, për shembull Më vrau me fjalë etj.*

Po kjo fjalë në mjetet e informimit po del shpesh edhe me kuptime të tjera që s'kanë lidhje me kuptimin e saj. Le t'i japim disa konstrukte fjalish, në të cilat mund të vërehet përdorimi gabim i kësaj fjale p. sh.: **Në aksident pati shumë të plagosur dhe të**

vrarë: Pesë persona u vranë dhe shumë të tjerë u lënduan nga përmytjet e fundit në Kaliforni, etj.

Edhe pse fjalët **vdekje**, **mbytyje** ose **vrasje**, në përgjithësi, janë të lidhura për një kuptim, ato prapëseprapë, varësisht nga pasojat që e sjellin këtë, në gjuhën shqipe dallohen semantikisht. Derisa fjala **vdekje** ka kuptimin e *të pushuarit së jetuari*, në përgjithësi, dy fjalët e tjera shprehin mënyrën dhe mjetin me atë të së cilës është shkaktuar kjo e para. Në rastet kur është fjala, pra, për fatkeqësi natyrore apo për aksidente komunikacioni etj. nuk mund të përdoret fjala **vras**, për arsye se bie ndesh me kuptimin e vërtetë të saj, por duhet të përdoret fjala tjetër **mbyty**. Edhe pse këto dy fjalë janë të ngjashme, siç thamë, për arsye se që të dyja si pasojë kanë "vdekjen", ato prapëseprapë kuptimisht ndryshojnë në mes vete. Derisa fjala **vras** (kuptimi i parë i saj është *e bëj të vdes dikë me armë, zakonisht me armë zjarri*), kjo e dyta, duke mos hyrë në kuptimet e tjera figurative, pra fjala **mbys**, **mbyty** e ka kuptimin *e bëj të vdes dikë duke e shtrënguar, për shembull fort në fytyrë, sa të mos marrë dot frymë* ose *e bëj të vdesë duke e zhytur në ujë* etj., ose *e bëj të vdesë duke e goditur me grushta e me gurë* etj., etj.

Duke e pasur parasysh çështjen se, duke u përsëritur shpesh edhe ato trajta të gabuara, një ditë ato mund të bëhen "të natyrshme", është e udhës që këto fjalë në konstruktet e dhëna më lart të mos dalin në këso formash, ashtu siç u theksuan, po të përdoren trajtat e drejta (sipas kuptimeve që kanë). Pra, nuk duhet të themi *Në aksident pati shumë të plagosur dhe të vranë*, ose *Pesë persona u vranë dhe shumë të tjerë u lënduan nga përmytjet e fundit në Kaliforni*, por: *Në aksident pati shumë të mbytytur (ose edhe shumë të vdekur) dhe të plagosur dhe Pesë persona u mbytytën (ose vdiqën) e shumë të tjerë u lënduan nga përmytjet e fundit në Kaliforni*; etj.

Shpesh na bie të dëgjojmë në mjetet tona elektronike të informimit, ose t'i shohim të shkruara, në gazeta, revista, e nganjëherë edhe në libra, edhe konstruktet e drejta të ndërtuara me kompozitën **bashkëngjit**. P. sh. *Aksionit iu bashkëngjitën edhe të moshuarit; Ekipit futbollistik "Prishtina" iu bashkëngjitën edhe lojtarë me përvojë, Korit të shkollës iu bashkëngjit edhe Gresa*, etj.

Që në fillim mund të bie në sy se në të gjithë këta shembuj fjala **bashkëngjit** (që në të shumtën e rasteve po del në trajtën **bashkangjit**) po përdoret gabim në raport me kuptimin e vërtetë të saj.

Ç'kuptim shpreh fjala **bashkëngjit**?

Kjo fjalë ka këtë kuptim: *Lidh së bashku një shkresë a një dokument me një shkresë a dokument tjetër kryesor, ia shtoj një shkresë a një dokumenti kryesor* **Bashkëngjiten** një shkresë, një listë, një pasqyrë, një formular etj (shih FGJSSH). Pra mund të **bashkëngjiten** (por jo të **bashkangjiten**) dy a më shumë elemente me ngjitës, kapëse apo me ndonjë mënyrë tjetër. Kështu pra mund të **bashkëngjiten** gjësende në mes veti, siç thamë, por nuk mund t'i **bashkëngjitet** njeriu ndonjë organizatë!? Është mjaft e çuditshme se si "hyri" kjo fjalë me këtë përdorim aq të gjerë. Po kjo, mbase, mund të shpjegohet me faktin se këto dy fjalë janë mjaft të ngjashme dhe duke u "nxituar", sidomos kur të kihet parasysh dinamika e zhvillimit të ngjarjeve në mjetet e informimit, siç thamë, edhe mund të "përzihet" njëra me tjetrën. Dallimi kryesor, pra, është se "**bashkoj**" përveç se mund të përdoret, për të shprehur nocionin (kuptimin) e "ngjitjes" me diçka të një shkresë me ndonjë shkresë tjetër, kjo fjalë mund të përdoret edhe për të shprehur "bashkimin" e

dy a më shumë frymorëve në një grup (ose në grupe të veçanta). P. sh. *Posa e hodha peshkun në det, ai u bashkua me të tjerët*, por kurrsesi *ai iu bashkëngjit të tjerëve*, sepse në këtë rast mund të kuptohet sikur peshku iu është "ngjitur" "lidhur" me një peshk tjetër ose një grupi të tillë?! Natyrisht se kur flasim, e as kur shkruajmë, askush nuk mendon kështu, sepse logjikisht kjo nuk ka kuptim. Por pasi që kështu nuk mendon askush, atëherë as nuk duhet ta shkruajmë e as ta themi në ligjërimet tona. Edhe fjalitë e tjera do të duhej të dilnin kështu: *Aksionit iu bashkuan edhe të moshuarit*, por jo *iu bashkëngjitën (as bashkangjitën) edhe të moshuarit*; Ose: *Ekipit futbollistik "Prishtina" iu bashkuan edhe lojtarë me përvojë*, e jo: *iu bashkëngjitën (bashkangjitën) edhe lojtarë me përvojë*; Ose: *Korit të shkollës iu bashkua edhe Gresa*, e jo: *iu bashkëngjit edhe Gresa* etj., etj.